



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“HASAN PRISHTINA”  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxhi Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 734  
Dated: 29/3/2023

Bazuar në nenin 6, nën-paragrafi 1.4, nenin 47, nën-paragrafi 1.1, si dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 48, nën-paragrafi 1.9 të Statutit, Senati i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në mbledhjen e mbajtur më 22.03.2023, miratoi:

**RREGULLORE  
PËR THEMELIMIN DHE PARIMET E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT PËR  
ETIKË NË KËRKIME SHKENCORE**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është të ofrojë bazën për themelimin dhe funksionimin e Komisionit për Etikë në Kërkime Shkencore që përfshijnë punën me subjekte humane dhe kafshë. Komisioni për Etikë në Kërkime Shkencore ka rol kryesor për të siguruar që aktivitetet kërkimore të ndërmarra nga hulumtuesit, studentët dhe palët e treta që kryejnë kërkime në ambientet e Universitetit të Prishtinës janë në përputhje me praktikën e mirë kërkimore dhe parimet etike dhe se respektohen gjatë gjithë kohës. Komisioni gjithashtu siguron që: të zbatohen dokumentet kuadër në nivel Evropian dhe kombëtar; të promovohet besimi i publikut në veprimtarinë kërkimore të Universitetit; të përbushen përgjegjësitë institucionale dhe individuale dhe mbrohen interesat e të gjitha palëve të përfshira në kërkime shkencore.

**Neni 2  
Shkurtesat**

1. Shkurtesat e përdorura kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1. UP - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- 1.2. KEKSH - Komisioni për Etikë në Kërkime Shkencore.

**Neni 3  
Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e Komisionit**

1. Të formulojë dhe të përcaktojë politikat, procedurat dhe dokumentet e bazuara në praktikat më të mira në lidhje me etikën në kërkime shkencore dhe të sigurojë që këto politika të zbatohen brenda fushave të përgjegjësisë;

2. Të promovojë dhe monitorojë zbatimin e standardeve të miratuara të etikës të përfshira në udhëzime, si dhe t'i shqyrtojë dhe rishikojë ato duke marrë parasysh zhvillimin e politikave;
3. Të promovojë çështjet e etikës dhe integritetit në kërkime shkencore në UP;
4. T'i shqyrtojë të gjitha aplikimet e dorëzuara në UP për shqyrtim etik, duke siguruar që praktikat e kërkimit t'i përbushin standartet etike nga dokumentet kuadër në nivel kombëtar dhe Evropian;
5. Të veprojë në interes të plotë të pjesëmarrësve në kërkim dhe komuniteteve, duke marrë parasysh nevojat e hulumtuesve dhe duke pasur parasysh kërkimesat e agjencive rregullatore përkatëse dhe ligjet në fuqi;
6. Të kryejë një shqyrtim të pavarur, kompetent dhe në kohë të kërkimit të propozuar nga stafi dhe studentët në të gjithë Universitetin përpëra se ai të kryhet;
7. Të marrë vendime për vlefshmërinë e miratimeve të lejeve për hulumtim të lëshuara nga trupa tjera kompetentë në nivel vendi ose në nivel ndërkombëtar;
8. Të kujdeset që propozimet kërkimore të bëhen me atraktive për institucionet financuese dhe për të siguruar mbështetjen institucionale për stafin që ka marrë miratimin etik institucional;
9. Të sigurojë që ka një vlerësim të rregullt të etikës së projekteve kërkimore në vazhdim të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara (pasi që marrin miratimin/lejen);
10. Të siguroje që kërkimi të kryhet në kushtet në të cilat miratohet propozimi dhe të ndërmerrin hapat e nevojshëm kur ka devijime (përfshirë fillimin e procedurës për shkelje të Kodit të Etikës (në Këshillin e Etikës).

## **II. PËRBËRJA E KEKSH DHE PROCEDURA E EMËRIMIT**

### **Neni 4 Përbërja (anëtarët) e KEKSH**

1. KEKSH ka 9 (nëntë) anëtarë: prorektori për kërkime shkencore dhe nga një anëtar nga 8 (tetë) njësitë akademike të listuara në vijim:
  - 1.1. Fakulteti Filozofik (Departamenti i Sociologjisë ose i Psikologjisë);
  - 1.2. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore (Departamenti i Biologjisë);
  - 1.3. Fakulteti i Filologjisë
  - 1.4. Fakulteti Juridik;
  - 1.5. Fakulteti i Mjekësisë;
  - 1.6. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Departamenti i Veterinarisë ose Departamenti i Bioteknologjisë në Zootekni - Prodhimit shtazor);
  - 1.7. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit;
  - 1.8. Fakulteti i Edukimit.

2. Sipas nevojës, Komisioni mund të formojë nën-komisione
3. Njësitë akademike mund të formojnë komisione në nivel fakulteti me qëllim mbështetjen e stafit dhe studentëve në hartimin e kërkesës së tyre për KEKSH. Këto komisione do të bëjnë shqyrtim preliminar të aplikimeve dhe do të bëjnë rekandime për KEKSH.
4. Zyra për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara (ZKPS) do të kryejë pjesën administrative të punës për KEKSH

#### **Neni 5**

#### **Procedura për propozimin dhe emërimin/aprovimin e përbërjes së KEKSH**

1. Anëtarët e KEKSH zgjedhen nga Senati, pas propozimit nga Rektori.
2. Propozimi i Rektorit përfshinë edhe nominimin për kryesuesin dhe zëvendës-kryesuesin e KEKSH;
3. Mandati i përbërjes së KEKSH lidhet me mandatin e Senatit.

### **III. PARIMET E FUNKSIONIMIT TË KEKSH**

#### **Neni 6**

#### **Mbledhjet/takimet e Komisionit, shqyrtimi i aplikimeve, vendimmarrja, hartimi dhe miratimi i dokumenteve, raportimi**

1. Brenda 30 ditëve pas themelimit, KEKSH harton Rregulloren e punës të cilën ia propozon Senatit për miratim;
2. Rregullorja (ndër çështje të tjera) përfshin:
  - 2.1. Mbledhjet/takimet dhe çështjet e kuorumit;
  - 2.2. Detyrat dhe përgjegjësitë e ZKPS për çështjet administrative;
  - 2.3. Detyrat dhe përgjegjësitë e nën-komisioneve që mund të formohen;
  - 2.4. Procedura/udhëzimet që duhen ndjekur lidhur me kërkesën për leje të punës kërkimore;
  - 2.5. Procedurat e vendimmarrjes që siguron adresimin në kohë dhe të duhur të kërkësave;
  - 2.6. Procedurën në rastet e vlefshmërisë së lejes (kur lëshohet nga organe të tjera si Qendra Klinike Universitare ose organ kompetent nga një institucion partner në propozimet kërkimore);
  - 2.7. Procedurën në raste kur komisionet në nivel fakulteti (në rastet kur ka komisione të tillë) kanë shqyrtuar kërkesën;
  - 2.8. Procedurën e ankimimit;
  - 2.9. Detyrimet e përshkruara saktësisht të anëtarëve në lidhje me:
    - 2.9.1. Lehtësimin e shqyrtimit dhe diskutimit të vazhdueshëm për çështjet e etikës dhe sigurimin që hulumtuesit janë të njojur me të gjitha praktikat dhe legjislacionin më të mirë të duhur;
    - 2.9.2. Kontributin në punën e Komisionit;
    - 2.9.3. Pjesëmarrjen e rregullt e takimeve;
    - 2.9.4. Dorëheqjen dhe zëvendësimin e anëtarëve;

- 2.9.5. Deklarimin e çdo konflikti interesit që mund të ndikojë në rolin dhe performancën e tyre si anëtarë të Komisionit;
- 2.9.6. Etj.
4. KEKSH zhvillon dokumente të tjera të nevojshme – formularë, udhëzime etj., të cilat bazohen në dokumente kuadër në nivel vendi dhe nivel ndërkombëtar (duke trajtuar çështje të tilla sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi) me qëllim që të lehtesojë punën e Komisionit. Dokumentet e nevojshme do të përgatiten brenda tridhjetë (30) ditëve pas miratimit të Rregullores për Rregulloren dhe Procedurat.
- 4.1. Gjatë zhvillimit të dokumenteve të nevojshme, KEKSH do të marrë në konsideratë me kujdes të gjitha aspektet etike dhe ligjore të kërkimit që përfshin subjektet njerëzore, përdorimin e mostrave biologjike me originë njerëzore dhe përdorimin dhe/ose mbledhjen e të dhënave personale.
- 4.2. Gjatë zhvillimit të dokumenteve të nevojshme, KEKSH do të marrë në konsideratë me kujdes të gjitha aspektet etike, ligjore dhe të mirëqenies së kërkimit të propozuar që përfshin kafshët, me vëmendje të veçantë për:
- 4.2.1. Nevojën për zëvendësimin e kafshëve kudo që është e mundur me kërkime që nuk përdorin kafshë;
  - 4.2.2. Zvogëlimin e numrit të kafshëve të përdorura në një masë që nuk rrezikon dizajnin ose rezultatet eksperimentale;
  - 4.2.3. Teknikat e përdorura në kërkime në mënyrë që të minimizohet ndikimi negativ në subjektet e kafshëve.
5. Dokumentet (udhëzimet) për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e kërkimit të aprovuar përmes do të hartohen nga KEKSH;
6. Në rastet kur është e nevojshme, KEKSH do të sigurojë ekspertizën nga individët dhe institucionet (jashtë KEKSH) brenda dhe jashtë Universitetit të Prishtinës;
7. KEKSH i raporton rektorit të Universitetit të Prishtinës.

#### **IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

##### **Neni 7 Dispozitat përfundimtare**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Senati i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
2. Ndryshimi dhe plotësimi i rregullores bëhet me të njëjtën procedurë me të cilën është miratuar.

